

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**

Përmbajtje

	Page
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e flukseve monetare	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Shënime të pasqyrave financiare	5-25

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Aksionarëve të Shoqërisë SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditues tjetër, raporti i të cilit më datë 25 qershor 2019, shpreh një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Net-SFS Kreston Sh.p.k.

Rruga Muhamet Gjollesha, shk. B, K. 6, Ap. B-6

Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001

Numri I Identifikimit të Personit të Tatuashëm L420070121

Rezar LLUKAÇEJ

Auditues Ligjor
Partner Angazhimi

Tiranë më, 21 prill 2020



SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)


	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	196,972,512	237,692,864
Aktive me të drejtë përdorimi	6	30,464,300	-
Aktivet afatgjata jomateriale	7	708,780	-
Aktive tatimore të shtyra	8	20,524,855	25,305,255
		248,670,447	262,998,119
Aktivet afatshkurtra			
Inventari	9	53,163,202	77,937,418
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	6,992,953	3,719,644
Parapagime dhe aktive të tjera	11	9,147,853	7,265,916
Mjete monetare dhe ekuivalentë	12	22,780,038	17,512,160
		92,084,046	106,435,138
Totali i aktiveve		340,754,493	369,433,257
KAPITALI			
Kapitali i paguar	17	150,000,000	300,000,000
Humbje/fitime të akumuluar		93,365,281	(56,309,120)
		243,365,281	243,690,880
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet e qirasë	13	12,849,072	-
Provizionet	6	534,796	493,810
		13,383,868	493,810
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime e qirasë	13	17,954,454	-
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	20,036,959	79,361,386
Tarifa e koncesionit e pagueshme	15	18,603,374	17,189,091
Tatim fitimi për t'u paguar	25	2,484,238	5,533,636
Detyrime të tjera	16	24,926,319	23,164,454
		84,005,344	125,248,567
Totali i detyrimeve		97,389,212	125,742,377
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		340,754,493	369,433,257

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri më 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të SICPA Security Solutions Albania sh.p.k më datë 21 Prill 2020 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



 Samir Shqarri
 Administrator


 Juliana Mali
 Menaxhere e Financës dhe
 Burimeve Njerëzore

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor***(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga kontratat me klientët	18	930,168,717	859,869,666
Kosto e mallrave të shitur	20	(414,591,008)	(376,278,963)
Fitimi bruto		515,577,709	483,590,703
Të ardhura të tjera	19	12,064,691	8,013,724
Të ardhura të tjera		12,064,691	8,013,724
Furnizime dhe shërbime	21	(79,208,526)	(104,056,131)
Shpenzime për personelin	22	(105,525,605)	(124,074,433)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	(67,019,801)	(52,600,662)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	(10,988)	-
Honorare për të drejtat e autorit	23	(49,008,984)	(45,117,237)
Tarifa e koncesionit	15	(18,603,374)	(17,197,393)
Shpenzime operative		(319,377,278)	(343,045,856)
Fitimi operativ		208,265,122	148,558,571
Të ardhura financiare		6,290,380	3,948,411
Shpenzime financiare		(7,809,639)	(514,859)
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto	24	(1,519,259)	3,433,552
Fitimi para tatimit		206,745,863	151,992,123
Shpenzimi i tatim fitimit	26	(32,625,462)	(23,629,207)
Fitimi për vitin		174,120,401	128,362,916
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		174,120,401	128,362,916

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukse monetare nga veprimtaritë operative			
Fitimi para tatimit		206,745,862	151,992,123
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	67,019,801	52,600,662
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	10,988	-
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve	21	152,838	-
Zhvlerësimi i inventarëve	9	2,622,592	(135,199)
Nxjerrje jashtë përdorimit e inventarëve	9	874,098	940,719
Efekti i skontimit të provizionit	25	40,986	(85,373)
		277,467,165	205,312,932
Ndryshime në:			
Rënia ne inventar	9	21,277,526	4,926,469
Rritja në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	(3,273,309)	(2,113,792)
Rritja në parapagime dhe aktive të tjera	11	(1,881,937)	(324,579)
Rënia në llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	(209,324,427)	(104,825,887)
Rritja/rënia në tarifën e koncensionit	15	1,414,283	(2,315,637)
Rritja/rënia në detyrime të tjera	16	(1,287,533)	2,401,655
		84,391,768	103,061,161
Mjete monetare realizuar nga veprimtaritë operative			
Interes i paguar		-	(180,752)
Tatim-fitimi i paguar	26	(27,845,062)	(22,861,771)
		56,546,706	80,018,638
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(57,636,355)	(113,949,002)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	18	-	549,252
		(57,636,355)	(113,399,750)
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese			
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese			
Detyrime nga qiraja	13	30,803,526	-
Divident te pagueshem	17	(24,446,000)	-
		6,357,526	-
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë financuese			
Pakësimi / (rritja) neto në mjete monetare dhe ekuivalente		5,267,877	(33,381,112)
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 janar		17,512,160	50,893,272
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor		22,780,038	17,512,160

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Pasqyra ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i paguar	Humbjet e akumuluar	Totali
Gjendja më 1 Janar 2018	404,000,000	(184,672,036)	219,327,964
Fitimi për vitin	-	128,362,916	128,362,916
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	128,362,916	128,362,916
Transaksione me pronarët e Shoqërisë			
Ulje e kapitalit të paguar	(104,000,000)	-	(104,000,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	300,000,000	(56,309,120)	243,690,880
Fitimi për vitin	-	174,120,401	174,120,401
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	174,120,401	174,120,401
Transaksione me pronarët e Shoqërisë			
Ulje e kapitalit të paguar	(150,000,000)	-	(150,000,000)
Dividendë të paguar	-	(24,446,000)	(24,446,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	150,000,000	93,365,281	243,365,281

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Njësia raportuese

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. ("SICPA" ose "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më 20 shtator 2010 me NIPT L02120032R.

Veprimtaria e Shoqërisë konsiston në implementimin e Marrëveshjes së Koncesionit për Shërbim ('Marrëveshja e Koncesionit') të lidhur midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë ('Autoriteti') për printimin, prodhimin dhe furnizimin e pullave fiskale si dhe veprimtari të tjera në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit si krijimi dhe mirëmbajtja e një Godine Prodhimi Qendrore në ambientet që do të caktohen nga Autoriteti: projektimin, zhvillimin, financimin, testimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemit, Sistemin Qendror të Gjurmimit dhe Monitorimit dhe Njësitë Kompjuterike gjatë periudhës së marrëveshjes. Koncesioni është dhënë për një afat prej 10 vitesh duke filluar që nga data në të cilën kontrata hyn në fuqi ('Data efektive').

Marrëveshja e Koncesionit nuk u bë plotësisht efektive gjatë vitit 2019, pasi legjislacioni përkatës mbi kërkesat e pullave fiskale nuk është miratuar plotësisht për të gjitha produktet e parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit. Shoqëria nuk ka marrë asnjë konfirmim nga Autoriteti në datën e hyrjes në fuqi ('Datën efektive').

SICPA Security Solutions Albania zotërohet 100% nga SICPA SA me vendndodhje në Zvicër (shoqëria mëmë) dhe është pjesë e Grupit SICPA. Shoqëria mëmë përfundimtare është SICPA Holding SA.

Përmes vendimit të datës 18 shtator 2018, Bordi i Drejtorëve të SICPA vendosi të emërojë Z. Samir Shqarri si Administrator të Shoqërisë duke filluar nga 23 korriku 2018, për një periudhë prej pesë vjetësh.

Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Kashar, Rruga Gryka e Kacanikut, Autostrada Tiranë – Durrës, Km 5, SH2, Tiranë, Shqipëri.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 ishte 40 (2018: 40).

2. Baza e kontabilitetit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ky është seti i parë i pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë, në të cilat është zbatuar SNRF 16- Qiratë.

Baza e kontabilitetit sipas parimit të vijmësisë

Drejtimi beson se Shoqëria do vazhdojë të realizojë fitime në të ardhmen dhe nuk do të çenohet parimi i vijmësisë. Ndaj, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vijmësisë.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore kontabël që janë përdorur në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë. Përveç ndryshimeve të politikave kontabël që rezultojnë nga zbatimi për herë të parë i SNRF 16, në fuqi nga 1 janari 2019, këto politika janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura. Politikat kryesore kontabël në lidhje me qiratë (SNRF 16) paraqiten në Shënimin 3.15 dhe 3.16.

3.1 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Lekë që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

Transaksionet dhe gjendjet

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve.

Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi apo humbja nga elementet monetare është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me normën efektive të interesit, dhe pagesave gjatë periudhës dhe kosto të amortizuar në monedhë të huaj e konvertuar me normën e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jomonetare të njohura në monedhë të huaj, që janë vlerësuar me kosto historike, janë konvertuar me kursin në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet jomonetare të njohura në monedhë të huaj e që janë vlerësuar me vlerë të drejtë, janë konvertuar me kursin në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar apo zhvlerësimin, nëse ka.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribuueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit një pjesë e makinerive dhe pajisjeve teknike mbeten në pronësi të Shoqërisë, por u jepen në përdorim pa pagesë dhe instalohen pranë ambienteve të klientëve të cilët i përdorin për prodhimin e pullave fiskale.

Kostot e mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohen vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kosto të tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktiviteti afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivitetit dhe njihen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi

Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të çdo pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga momenti kur është i gatshëm për përdorim. Përmirësimet e ambienteve të marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet periudhës së kohëzgjatjes së qiramarrjes dhe jetëgjatësisë së tyre.

Jetëgjatësitë e vlerësuara të aktiveve afatgjata materiale për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Përmirësimet e kryera në ambientet me qira	Afati i qirasë
Instalime	5 vite
Pajisje zyre	5 vite
Kompjuterë dhe pajisje IT	4 vite
Makineri dhe pajisje teknike	5 - 10 vite

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata jomateriale përfshijnë licencat e blera për programe kompjuterike, të cilat janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar apo zhvlerësimin, nëse ka.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit.

Kostot e mëpasshme

Kosto të tjera të mirëmbajtjes janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktiviteti afatgjatë jomaterial përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivitetit dhe njihen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi

Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar nga Shoqëria me 4 vite.

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera kontabël neto mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera e mbetur e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim të aktivitetit. Për qëllime të përcaktimit të zhvlerësimit, aktivitetet grumbullohen në njësitë më të vogla për të cilat ka hyrje të flukseve monetare të pavarura (njësi gjeneruese të mjeteve monetare).

3.6 Instrumente financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale mbi instrumentin.

Instrumentet financiare - njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktivitetet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

Aktivitetet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivitetet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare”) ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje”) ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivitetet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit “të tjera” dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivitetet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivitetin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar fluksat e mjeteve monetare për aktivitetet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivitetet e saj financiare.

Aktivitetet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objektivi mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse fluksat e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (“VPPI”). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse fluksat e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktiviteti dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në kryerjen e testit VPPI për aktivitetet e saj financiare.

Aktivitetet financiare - fshirja. Aktivitetet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer çdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paaftësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivitetet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivitetet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitetet financiare kur (a) aktivitetet shlyhen ose të drejtat për fluksat e mjeteve monetare nga aktivitetet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivitetet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivitetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Instrumente financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare - kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare - çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Netimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera dhe huatë afatshkurtra. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Shoqërisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion midis palëve të vullnetshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe evidentohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikën e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma me të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare minus çdo pagesë e principali, plus interesin e përlogaritur dhe për aktivet financiare, minus çdo zbritje për humbje të pritshme të kredisë.

3.7 Parapagimet

Parapagimet maten me koston minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin priten të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivitetit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivitetit dhe pret nga ky aktiv përfitime ekonomike të ardhshme. Parapagimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

3.8 Inventarët

Inventarët paraqiten me më të voglën mes koston dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e koston standarde dhe përfshin materialet e papërpunuara, shpenzimet e transportit dhe sigurimit, punën e drejtpërdrejtë, zhvlerësimet dhe fshirjet e inventarit dhe kthimet e inventarit. Analiza periodike e variancës kryhet nga Shoqëria për të krahasuar koston aktuale kundrejt koston standarde dhe diferencat që rezultojnë nga analiza të tilla janë regjistruar si "kosto e mallrave të shitura". Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes fikse për njësi siç përcaktohet në Marrëveshjen e Koncesionit minus koston e përlogaritur të kompletimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për shitjen. Çdo zhvlerësim i inventarit dhe rimarrje e zhvlerësimit në vlerën neto të realizueshme përfshihen në koston e mallrave të shitura.

3.9 Tatim fitimi aktual dhe tatimi i shtyrë

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në llogaritë e fitim-humbjes, përveç pjesës që lidhet me elementet që njihen drejtpërdrejt në llogarinë e kapitalit ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës llogaritet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në datën e raportimit.

Drejtimi vlerëson në mënyrë periodike trajtimet fiskale në deklaratat tatimore të lidhura me situata në të cilat legjislacioni përkatës tatimor mund të jetë subjekt interpretimi. Drejtimi ngre provizione në rastet ku shihet e arsyeshme, të bazuara në shumat e pritshme për t'u paguar ndaj autoriteteve tatimore.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.9 Tatim fitimi aktual dhe tatimi i shtyrë (vazhdim)

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferenat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Aktivitetet për tatime të shtyra njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Aktivitetet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto nëse ka një të drejtë të kërkueshme me ligj për të netuar aktivitetet dhe detyrimet aktuale tatimore dhe ato lidhen me tatime mbi fitimin të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor për të njëjtin subjekt tatimor ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ato kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivitetet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivitetet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Trajtimet e pasigurta tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e trajtimeve tatimore të pasigurta të cilat mund të sjellin detyrime dhe kamatëvonesa shtesë. Trajtimet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga Drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet njihen për trajtimet e tatimit mbi fitimin për të cilat drejtimi gjykon se më shumë është e mundshme sesa jo, që të rezultojë në detyrim tatimor shtesë nëse trajtimet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga Drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozitat do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që kanë hyrë në fuqi ose janë miratuar deri në fund të periudhës raportuese, dhe ndonjë vendim gjykate për çështje të ngjashme. Detyrimet për gjoba, kamatëvonesa dhe tatime të tjera përveç atyre mbi të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç kamatëvonesave dhe gjobave, njihen tek shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesin dhe gjobat njihen tek shpenzime financiare dhe fitime/ (humbje) të tjera, neto, respektivisht.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

Leja vjetore e paguar

Shoqëria njihet si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të përlogaritura lidhur me lejen vjetore të parashikuar për t'u paguar në shkëmbim të shërbimit të punonjësve për periudhën.

3.11 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, kur ekziston mundësia e flukseve dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimet, dhe kur vlera e detyrimit mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme. Provizionet nuk mund të njihen për humbje operative të ardhshme.

Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve të pritshme për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Rritja në provizione si pasojë e kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi.

Provizionet rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe rregullohen për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual. Nëse nuk ekziston më një mundësi që të kërkohej një dalje e burimeve për të shlyer detyrimin, atëherë provizioni rimerret.

3.12 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukse që lindin gjatë aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në masën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të marrë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përfshirë shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.12 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Shitjet e mallrave (pulla fiskale)

Shitjet njihen kur kontrolli i mallit është transferuar, qoftë kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, klienti ka kontroll të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrime të paplotësuara që mund të ndikojnë në pranimin e mallrave nga klienti. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendndodhjen specifike, rreziqet e vjetërsimit dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe konsumatori ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, dispozitat e pranimit janë anuluar ose Shoqëria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Asnjë element i financimit nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat kredie më pak se 12 muaj.

Një e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi ky është momenti kur pagesa bëhet e pakushtëzuar, sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës përpara se pagesa të kryhet.

Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhurat e njohura nga ringarkimi të SICPA Security Solutions SA i shpenzimeve të udhëtimit të kryera nga stafi i Shoqërisë.

3.13 Shpenzime

Shpenzimet njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

3.14 Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë pagesat bankare, kthimin e zbritjes nga provizionet dhe fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen në baza neto.

3.15 Qiratë

Politikat kontabël pas 1 Janar 2019

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka njohur: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Zbatimi për herë të parë i SNRF 16 nga Shoqëria është paraqitur tek shënimi numër 3.16.

SNRF 16 mbar të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

- a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;
- c) çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- d) dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitetit bazë

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontoohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

3.Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.15 Qiratë (vazhdim)

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar cdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

Politikat kontabël para 1 Janar 2019

Para datës 01 Janar 2019, Shoqëria ka zbatuar kërkesat e SNK 17, në të cilën konstatohet se kur Shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje, e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga qiradhënësi tek Shoqëria, pagesat e qirasë ngarkohen në fitim ose humbje për vitin në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Afati i qirasë është periudha e paanullueshme për të cilën qiramarrësi ka kontraktuar te marre me qira aktivin së bashku me çdo periudhë tjetër për të cilin qiramarrësi ka opsionin të vazhdojë të mbajë me qira aktivin, me ose pa pagesë të mëtejshme, kur në fillim të qiradhënies ka siguri të arsyeshme se qiramarrësi do ta ushtrojë opsionin e zgjatjes së periudhës së qiramarrjes.

3.16 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Zbatimi i SNRF 16 "Qirate"

Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin nga data e tij e zbatimit të detyrueshëm, 1 janar 2019, duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shumave krahasuese. Detyrimi i qirasë në datën e zbatimit fillestar është në shumën prej 48,537,397 lekë dhe matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat janë ende të papaguara. Pagesat e qirasë janë skontuar me normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Aktivet me të drejtë përdorimi janë matur në tranzicion në shumën e detyrimit të qirasë 48,537,397 Lekë. Impakti i SNRF 16 në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2019, paraqitet në shenimet 6 (aktivet me të drejtë përdorimi dhe amortizimi), 13 (detyrimi i qirasë), 24 (shpenzimi i interesit).

Në aplikimin për herë të parë të SNRF 16, Shoqëria për kontratat ekzistuese, ka përdorur lehtësirat praktike në vijim:

- Shoqëria ka zbatuar një normë skontimi të vetme për një portofol me karakteristika të ngjashme, konkretisht, për qiranë për ndërtesën ka përdorur një normë skontimi 5,11%, ndërsa për qiranë e mjeteve të transportit ka përdorur një normë skontimi 4,58%. Normat e skontimit të përdorura nga Shoqëria janë normat e kredive në Euro, sipas jetëgjatësisë së kontratës, publikuar nga Banka e Shqipërisë;
- Shoqëria ka përjashtuar kostot fillestare të drejtëpërdrejta nga matja e aktiveve me të drejtë përdorimi për kontratat ekzistuese;
- Shoqëria nuk i ka marrë në konsideratë parapagimet e kryera për kontratat ekzistuese.

Tabela në vijim paraqet një rikoncilim të angazhimeve të qirasë operative në 31 dhjetor 2018 dhe detyrimin e qirasë më 01 janar 2019 së bashku me efektin e skontimit.

	31 dhjetor 2018/ 1 janar 2019
Pagesat totale minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të pa-anullueshme	52,012,955
- Pagesat e ardhshme të qirasë përfshirë opsionin e zgjatjes së periudhës së qiramarrjes	48,537,397
- Pagesat e ardhshme të qirasë së ndryshueshme që bazohen në një indeks ose një normë	-
- Efekti i skontimit në vlerën aktuale	3,475,558

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2019, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

- KIRFN 23 "Paqartesi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja" (publikuar më 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

3.16 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

- Ndryshime në SNK 28, "Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta" (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 "Përmirësime vjetore të SNRF-ve për ciklin 2015-2017" (publikuar në 12 dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)

3.17 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

Ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar në 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në SNRF 3 "Perkufizimi i një biznesi" (publikuar në 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet e bera për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7 "Studim krahasueshmërie për reformën e normës së interesit" (publikuar më 26 shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata-Ndryshime në SNK 1 (publikuar në 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, Drejtimi ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit që përfundon më 31 dhjetor 2019 është dhënë më poshtë.

Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri. Për përcaktimin e shumës së tatimit të shtyrë kërkohet një gjykim i rëndësishëm. Ka transaksione dhe përlllogaritje për të cilat shuma përfundimtare e tatimit është e pasigurt. Shoqëria njeht detyrime për çështje të kontrolleve të pritura tatimore bazuar në vlerësimet nëse do të ketë detyrime shtesë. Kur rezultati përfundimtar i këtyre çështjeve është i ndryshëm nga shumat e regjistruara fillimisht, këto ndryshime do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe të shtyra të tatimeve në periudhën në të cilën bëhet një përcaktim i tillë.

Njohja e aktivitetit të tatimit të shtyrë

Aktivitetit të shtyrë të njohura përfaqësojnë tatimin mbi fitimin që mund të rikuperohet përmes zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme, kryesisht të lidhura me diferencat midis amortizimit kontabël dhe fiskal të aktiveve afatgjata materiale, duke rezultuar në bazën tatimore të këtyre aktiveve më të larta se vlerat përkatëse të tyre kontabël. Aktivitetit të shtyrë njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e tatueshme të ardhshme dhe shumat e përfitimeve tatimore që janë të mundshme në të ardhmen bazohen në planin afatmesëm të biznesit të përgatitur nga Drejtimi rezultatet e të cilit aplikohen më pas për vitin 2019. Plani i biznesit bazohet në pritjet e menaxhimit që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat.

4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Pavarësisht shtyrjes së prodhimit të pullave fiskale për produktet farmaceutike, Drejtimi beson se Shoqëria do të vazhdojë të jetë fitimprurëse në të ardhmen bazuar në linjat e prodhimit që janë të mjaftueshme për të gjeneruar fitime të tilla dhe flukse monetare operative pozitive. Vlerësimi i vlerave të aktiveve afatgjata është çështje e gjykimit bazuar në përvojën, kushtet aktuale dhe pritshmëritë për të ardhmen me aktive të ngjashme.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale

Vlerësimi i jetës së dobishme të zërave të aktiveve afatgjata materiale është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me aktive të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në aktive konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe tregtare dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të aktiveve. Drejtimi vlerëson jetët e dobishme të mbetura në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që aktivet të gjenerojnë përfitime për Shoqërinë. Konsiderohen faktorët kryesorë në vijim:

- (a) Përdorimi i pritshëm i aktiveve;
- (b) Konsumimi fizik i pritshëm, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe
- (c) Vjetërsimi teknik ose tregtar që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Drejtimi gjithashtu konsideroi se kriteret e fushës së KIRFN 12 'Marrëveshjet e Koncensionit të Shërbimit' nuk janë plotësuar për Marrëveshjen e Koncensionit dhe për këtë KIRFN 12 nuk është i zbatueshëm.

Vlerësimi i modelit të biznesit. Modeli i biznesit drejton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Shoqëria konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritshmëritë për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin e biznesit "mbaj për të mbledhur". Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të riskut të kreditimit, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit "mbaj për të mbledhur", me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Shoqëria vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes gjatë 3 viteve të fundit të aktivitetit financiar, përpara 1 janarit 2019. Gjithashtu, shitja e aktiveve financiare e pritshme vetëm në skenarë të një vështirësie financiare, ose në përgjigje të një ngjarjeje të izoluar që është përtej kontrollit të Shoqërisë, nuk është e përsëritur dhe nuk mund të ketë qenë parashikuar nga Shoqëria, konsiderohen si të rastësishme ndaj objektivit të modelit të biznesit dhe nuk ndikojnë në klasifikimin e aktiveve financiare përkatëse.

Modeli i biznesit "mbaj për të mbledhur dhe shitur" nënkupton që aktivet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një marzhi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato aktive.

Kategoria e mbetur përfshin ato portofole të aktiveve financiare, të cilat menaxhohen me qëllim të realizimit të flukseve monetare kryesisht nëpërmjet shitjes, si p.sh. kur ekziston një model tregtimi. Mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale shpesh është e rastësishme për këtë model biznesi.

Për kalimin në SNRF 9, Shoqëria identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbaj për të mbledhur", me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk i jepet riskut të çmimit ose vlerës së drejtë;
- Deri tani nuk ka pasur asnjë shitje. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të riskut të kredise, që rezulton nga shkeljet e kriterëve të brendshme të riskut të kredise. Këto shitje do të ishin në përputhje me një model biznesi "mbaj për të mbledhur". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore.

Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbaj për të mbledhur".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit ("VPPI"). Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kërkon gjykim.

Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e SNRF 15, që konsiderohet të jetë principal. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matja e humbjes së pritshme të kredisë. Zbritjet për humbjet e pritshme të kredisë llogariten për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse llogaritë e arkëtueshme nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, vlera e humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kredise përgjatë jetës së këtyre aktiveve. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionimi në të cilën llogariten kostot e humbjeve për llogaritë e arkëtueshme që i përkasin periudhave të ndryshme të maturimit ose vonesës.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve (vazhdim)

Matja e humbjes së pritshme të kredisë (vazhdim)

SNRF 9 shpjegon përdorimin e këtyre matricave të provizionimit në shembujt ilustrues, por nuk specifikon se si duhet të përcaktohen normat në praktikë. Megjithatë, është e qartë se normat e dhëna, dhe rrjedhimisht llogaritja e humbjeve si një përqindje e balancës, duhet të rritet për periudhat më të gjata të vonesës. Shoqëria aplikoi metodologjinë e mëposhtme për të llogaritur normat e mosshlyerjes. Për të llogaritur normat, Shoqëria i ka ndarë balancat në grupe homogjene bazuar në ngjashmërinë e riskut të kredisë dhe sjelljen e kaluar të klientit. Si rezultat i analizës, Shoqëria arriti në përfundimin se ka vetëm një grup homogjen: të arkëtueshmet nga klientët e korporatave. Analiza e mëposhtme u krye për grupin e identifikuar.

Hapi 1: Përcaktimi i periudhës së shitjeve dhe borxhet e këqija në lidhje me këto shitje

Për grupin e të arkëtueshmeve, njësia ekonomike përcakton një periudhë historike të shitjeve dhe përcakton se sa prej të arkëtueshmeve në lidhje me këto shitje kanë rezultuar në humbje të mjeteve monetare. Periudha e shitjeve të përdorura duhet të jetë e tillë që humbjet historike që rezultojnë të jenë një përfaqësim i vlefshëm i modeleve të humbjes. Për shembull, të dhënat për vetëm disa muaj nuk kanë të ngjarë të jenë të mjaftueshme, edhe pse përdorimi i një periudhe shumë të gjatë mund të mos jetë e përshtatshme nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në treg gjatë asaj periudhe. Një periudhë prej 3 vjetësh, nga viti 2016 deri në vitin 2018, përcaktohet të jetë e përshtatshme duke marrë parasysh se nuk ka pasur ndonjë ndryshim në modelin e pagesës për këtë periudhë për grupin e të arkëtueshmeve.

Shitjet bruto të bëra me kredi për këtë periudhë arritën në 147,742,565 Lekë dhe për këto shitje nuk ka pasur humbje të mjeteve monetare.

	Totali	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shitjet me kredi (të arkëtueshme)	147,742,565	3,719,644	2,155,104	141,867,817

Hapi 2: Llogaritja e profilit historik të pagesave të të arkëtueshmeve tregtare

Për të përcaktuar normën historike të mosshlyerjes për secilin interval kohor të llogarive të arkëtueshme, është përcaktuar profili i pagesës për të arkëtueshmet që lindin gjatë periudhës historike të shitjeve.

Totali i Shitjeve	147,742,565	Totali i paguar:	Profili i maturimit të shitjeve (hapi 3)
Paguar në 30 ditë:	(2,983,395)	(2,983,395)	144,759,170
Paguar midis 30-60 ditë:	(3,137,099)	(6,120,495)	141,622,070
Paguar midis 60-90 ditë:	(485,301)	(6,605,796)	141,136,769
Paguar pas 90 ditësh:	(141,076,557)	(147,682,352)	60,213

Vlera prej 60,213 Lekë korrespondon me faturime, për të cilat malli nuk është tërhequr nga klientët. Shoqëria ka ndjekur procedurën me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe pret konfirmimin nga ana e tyre për anulimin e këtyre shitjeve gjatë vitit 2020.

Hapi 3: Llogaritja e normës historike të humbjeve

Ky hap llogarit normën historike të humbjes për çdo interval kohor të llogarive të arkëtueshme. Për çdo interval, norma historike e humbjes mund të përcaktohet duke pjestuar humbjen përfundimtare (zero) me shumën e papaguara në atë interval, siç ilustron më poshtë:

	Shitjet aktuale	Pagesa të mbetura pas 30 ditësh	Pagesa të mbetura pas 60 ditësh	Pagesa të mbetura pas 90 ditësh
Profili i maturimit të shitjeve:[1]	147,742,565	144,759,170	141,622,070	141,196,982
Humbja: [2]	-	-	-	-
Shkalla e humbjes [2] / [1]	0%	0%	0%	0%

Hapi 4: Rregullimi i normës së humbjes për informacionin aktual dhe të ardhmes

Norma historike e humbjeve duhet të rregullohet për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm që mund të ndikojë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme. Informacioni i tillë duhet të jetë i arsyeshëm dhe i besueshëm, dhe duhet të jetë i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Shoqëria ka identifikuar PBB-në dhe shkallën e papunësisë të vendeve në të cilat ajo ofron shërbimet e saj të jenë faktorët më të rëndësishëm dhe në përputhje me këtë rregullon normat historike të humbjeve bazuar në ndryshimet e pritshme në këta faktorë.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve (vazhdim)

Matja e humbjes së pritshme të kredisë (vazhdim)

Hapi 4: Rregullimi i normës së humbjes për informacionin aktual dhe të ardhmes

Shoqëria gjykon se mund të ketë një korrelacion historik mes normave të papunësisë dhe shkallës së humbjes. Në këtë rast, nëse papunësia gjatë periudhës së pritur të të arkëtueshmeve të papaguara pritet të jetë më e lartë ose më e ulët se mesatarja historike gjatë periudhës në të cilën janë vërejtur humbje, do të nevojitet një rregullim i humbjeve historike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat ekonomike për papunësinë dhe PBB / frymë për Shqipërinë dhe Zvicrën, ku janë vendosur marrësit e mallrave / shërbimeve.

		2016	2017	2018
Shqipëri	PBB për frymë	4,684	4,868	5,075
Shqipëri	Shkalla e papunësisë %	15.22	13.87	11.8
Zvicër	PBB për frymë	76,682	76,667	78,816
Zvicër	Shkalla e papunësisë %	3.3	3.2	2.6

Duke pasur parasysh se gjatë periudhës historike të analizuar të shitjeve ka pasur një rritje të lehte ekonomike dhe ulje të normave të papunësisë, kjo pritet që të mos çojë në ndonjë humbje shtesë.

Duke qenë se, shitjet dhe profili i pagesës pritet të mbeten materialisht të njëjtë me periudhën historike të shitjes, normat e humbjeve të pritshme llogariten siç tregohet më poshtë:

	Shitjet aktuale	Pagesa të mbetura pas 30 ditësh	Pagesa të mbetura pas 60 ditësh	Pagesa të mbetura pas 90 ditësh
Profili i maturimit të shitjeve: [1]	147,742,565	144,759,170	141,622,070	141,196,982
Humbja: [2]	-	-	-	-
Shkalla e humbjes [2] / [1]	0%	0%	0%	0%

Hapi 5: Llogaritja e HPK duke përdorur normat e pritshme të humbjes

Hapi i fundit është aplikimi i normave të pritshme të humbjes në profilin e maturimit të të arkëtueshmeve në datën e raportimit për të përcaktuar HPK totale:

	Të arkëtueshme totale	Aktuale	30–60 ditë	60–90 ditë	Pas 90 ditësh
Balanca e të arkëtueshmeve në datën e raportimit: [1]	6,919,967	1,373,257	5,486,497	-	60,213
Shkalla e humbjes: [2]		0%	0%	0%	0%
Humbja e pritshme e kredisë: [1] × [2]	-	-	-	-	-

Humbja e pritur e kredisë është zero, e cila është e njëjtë me atë që rezultoi gjatë periudhës historike të referencës.

5 Menaxhimi i riskut financiar

Veprimtaria e Shoqërisë e ekspozon atë ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare: rreziku i tregut (i cili përfshin rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun e normës së interesit), rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit. Programi i përgjithshëm i Shoqërisë për menaxhimin e riskut fokusohet në vendosjen e kufijve ndaj ekspozimeve ndaj rreziqeve të ndryshme.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në normat e kursit të këmbimit dhe nga normat e interesit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në një moment të dhënë kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të ligjeve dhe rregulloreve të nxjerra nga Autoriteti si dhe të pritshmërive për lëvizjet e ardhshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit të tregut.

Drejtimi vendos kufi për vlerën e rrezikut që mund të pranohet, nivel që monitorohet çdo muaj. Megjithatë, përdorimi i kësaj metode nuk i parandalon humbjet përtej këtyre kufijve në kushtet e lëvizjeve të mëdha në treg.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Rreziku i tregut

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria vepron dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në lidhje me Euron. Rreziku i kursit të këmbimit lind kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë në një monedhë që nuk është monedha funksionale e subjektit. Në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit, Drejtimi vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit ndaj çdo monedhe dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj.

Shoqëria nuk ka hyrë në transaksione mbrojtëse për ekspozimin ndaj rrezikut valutor pasi nuk pret humbje të rëndësishme për shkak të luhatjeve në kursin e këmbimit krahasuar me atë ekzistues në datën e raportimit.

Kurset e këmbimit për Euron shprehur në Lekë për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42
CHF	112.3	109.6

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 ishte si më poshtë:

	Lekë	Euro	CHF	Totali
31 Dhjetor 2019				
Aktive financiare				
Të arkëtueshme tregtare (shënimi 10)	-	6,919,967		6,919,967
Të arkëtueshme të tjera (shënimi 10)	-	72,986		72,986
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	302,555	22,477,483		22,780,038
	302,355	29,470,436		29,772,991
Detyrime financiare				
Detyrime qiraje (shënimi 13)		(30,803,526)		(30,803,526)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(559,864)	(18,819,859)	(657,236)	(20,036,959)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	(18,603,374)	-		(18,603,374)
	(19,163,238)	(49,623,385)	(657,236)	(69,443,859)
Rreziku i kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2019	(18,860,683)	(20,152,949)	(657,236)	(39,670,868)

	Lekë	Euro	Totali
31 Dhjetor 2018			
Aktive financiare			
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 10)	-	3,719,644	3,719,644
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	368,631	17,143,529	17,512,160
	368,631	20,863,173	21,231,804
Detyrime financiare			
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(496,503)	(78,864,883)	(79,361,386)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	(17,189,091)	-	(17,189,091)
	(17,685,594)	(78,864,883)	(96,550,477)
Rreziku i kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2018	(17,316,963)	(58,001,710)	(75,318,673)

(ii) Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset e mjeteve monetare operative nuk ekspozohen dukshëm në ndryshimet në normat e interesit të tregut.

Rreziku i kredisë

Shoqëria ndërmer një ekspozim ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar mund të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke mos shlyer një detyrim.

Rreziku i kredisë lind nga mjetet monetare dhe ekuivalente me to, dhe nga depozitat në banka dhe institucionet financiare, si dhe nga ekspozimi i kredisë me klientët, duke përfshirë llogari të arkëtueshme dhe transaksionet ku Shoqëria është tashmë e angazhuar.

Në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 ekspozimi i Shoqërisë ndaj palëve të treta për llogaritë tregtare të arkëtueshme është minimal, sepse klientët e Shoqërisë parapaguajnë porositë para dorëzimit. Shoqëria ka krijuar llogaritë e saj bankare pranë bankës Raiffeisen Bank në Shqipëri, bankë e cila ka një shkallë vlerësimi të BBB + nga Standard and Poor's.

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përkufizohet si rreziku që Shoqëria do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore lidhur me burimet e saj monetare, kryesisht për të shlyer shpenzimet operative gjatë aktiviteteve të saj rutinë. Drejtimi monitoron çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj parashikimin e vazhdueshëm të fluksit monetar të Shoqërisë.

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë sipas maturimit të tyre bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare kontraktuale të paskontuara sepse tepricat që shlyhen brenda 12 muajve janë të njëjta me vlerën e tyre neto kontabël pasi ndikimi i skontimit është i papërfillshëm. Përjashtim bën vetëm detyrimi i qirasë, i cili skontohej sipas normave përmendur tek shënimi 3.16.

31 Dhjetor 2019	Deri 3 muaj	3 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët financiarë					
Llogari të arkëtueshme tregtare (shënimi 10)	1,373,257	5,486,497	60,213	-	6,919,967
Të tjera të arkëtueshme	-	-	72,986	-	72,986
Mjete monetare dhe ekuivalente (shënimi 12)	22,780,038	-	-	-	22,780,038
	24,153,295	5,486,497	133,199		29,772,991
Detyrime financiare					
Detyrimi i Qirasë (shënimi 13)	-	-	(17,954,454)	(12,849,072)	(30,803,526)
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(20,036,959)				(20,036,959)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	-	(18,603,374)	-	-	(18,603,374)
	(20,036,959)	(18,603,374)	(17,954,454)	(12,849,072)	(69,443,859)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	4,189,322	(13,116,877)	(17,894,241)	(12,849,072)	(39,670,868)
31 Dhjetor 2018					
Aktivët financiarë					
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 10)	97,244	3,622,400	-	-	3,719,644
Mjete monetare dhe ekuivalente (shënimi 12)	17,512,160	-	-	-	17,512,160
	17,609,404	3,622,400			21,231,804
Detyrime financiare					
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera (shënimi 14)	(79,361,386)	-	-	-	(79,361,386)
Tarifa e koncesionit e pagueshme (shënimi 15)	-	-	(17,189,091)	-	(17,189,091)
	(79,361,386)		(17,189,091)		(96,550,477)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	(61,751,982)	3,622,400	(17,189,091)		(75,318,673)

Në datën e raportimit, aktivet financiare të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera dhe mjete monetare, ndërsa detyrimet financiare monetare përbëhen nga detyrimet tregtare, detyrimi i qirasë dhe të tjera të pagueshme. Drejtimi beson se Shoqëria, do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj duke përdorur flukset e pritshme të mjeteve monetare nga të ardhurat dhe do të gjenerojë flukse pozitive të parasë.

5.1 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Shoqëria është krijuar vetëm për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit. Sipas legjislacionit shqiptar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duhet të ketë kontribute në kapital nga ortakët, por nuk kërkohet që të krijojë rezerva ligjore. Kapitali është kontribuar nga ortakët në mjete monetare. Kapitali përfshin vetëm kapitalin e regjistruar, të paguar dhe fitimet e akumuluar.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

	Përmirësime të ambienteve me qira	Instalime	Pajisje informatike dhe pajisje zyre	Makineri dhe pajisje teknike	Totali
Kosto					
Më 1 Janar 2018	35,655,328	21,613,385	50,780,753	926,019,639	1,034,069,105
Shtesa	-	1,450,298	1,101,361	111,397,343	113,949,002
Pakësime	-	(1,665,960)	(5,654,952)	-	(7,320,912)
Më 31 Dhjetor 2018	35,655,328	21,397,723	46,227,162	1,037,416,982	1,140,697,195
Shtesa	-	140,651	1,391,998	6,846,541	8,379,190
Pakësime	-	-	(830,000)	(34,444,151)	(35,274,151)
Më 31 Dhjetor 2019	35,655,328	21,538,374	46,789,160	1,009,819,371	1,113,802,234
Amortizimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2018	(32,229,703)	(21,024,867)	(43,762,155)	(760,707,856)	(857,724,581)
Amortizimi për vitin	(3,162,083)	(374,443)	(2,884,403)	(46,179,733)	(52,600,662)
Pakësime	-	1,665,960	5,654,952	-	7,320,912
Më 31 Dhjetor 2018	(35,391,786)	(19,733,350)	(40,991,606)	(806,887,589)	(903,004,331)
Amortizimi për vitin	(263,543)	(417,632)	(2,901,063)	(45,364,466)	(48,946,704)
Pakësime	-	-	830,000	34,291,314	35,121,314
Më 31 Dhjetor 2019	(35,655,328)	(20,150,982)	(43,062,670)	(817,960,742)	(916,829,722)
Vlera kontabël neto					
Më 31 Dhjetor 2018	263,543	1,664,373	5,235,556	230,529,392	237,692,864
Më 31 Dhjetor 2019	-	1,387,392	3,726,491	191,858,629	196,972,512

i. Aktive me të drejtë përdorimi

	Ndërtesa	Mjete Transporti	Totali
Kosto			
Më 1 Janar 2019	-	-	-
Shtesa	38,239,942	10,297,455	48,537,397
Pakësime	-	-	-
Ne 31 Dhjetor 2019	38,239,942	10,297,455	48,537,397
Amortizim i akumuluar			
Më 1 Janar 2019	-	-	-
Amortizimi i vitit	(13,496,450)	(4,576,647)	(18,073,097)
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	(13,496,450)	(4,576,647)	(18,073,097)
Vlera kontabël neto			
At 1 January 2019	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	24,743,492	5,720,808	30,464,300

ii. Provizione për kostot e çmontimit

Provizionet për kostot e çmontimit rezultojnë nga kontratat e qirasë të zyrave qendrore dhe përbëhen nga shpenzime të ardhshme të përlogaritura për t'u kryer nga Shoqëria në përfundim të kontratës së qirasë të skontuar me normën e interesit të huave. Shoqëria zgjati afatin e qirasë për një periudhë tjetër deri më 31 janar 2022, ndërsa flukset monetare të parashikuara për të shlyer detyrimin kanë mbetur të pandryshuara. Lëvizja e provizioneve për kostot e çmontimit paraqitet si më poshtë:

Kostot e çmontimit	2019	2018
Më 1 janar	493,810	579,183
Efekt i skontimit të provizionit	40,986	(85,373)
Më 31 dhjetor	534,796	493,810

iii. Aktivet e mbajtura në ambientet e palëve të treta

Makineri e pajisje teknike me vlerë të mbartur prej Lekë 336,653,504 (2018: Lekë 96,990,323) përfaqësojnë aktive të Shoqërisë të cilat bazuar në Marrëveshjen e Koncesionit u jepen klientëve falas, instalohen në ambientet e tyre dhe përdoren për verifikimin e origjinalitetit të pullave.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

7. Aktive Afatgjata Jo Materiale

	Licensa programe kompjuterike	Aktive jomateriale në proces	Totali
Kosto			
Më 1 Janar 2018	94,132	-	94,132
Shtesa	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2018	94,132	-	94,132
Shtesa	65,927	653,841	719,768
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	160,059	653,841	813,900
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 Janar 2018	(94,132)	-	(94,132)
Amortizimi për vitin	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2018	(94,132)	-	(94,132)
Amortizimi për vitin	(10,988)	-	(10,988)
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	(105,120)	-	(105,120)
Vlera kontabël neto			
Më 31 Dhjetor 2018	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	(54,939)	653,841	708,780

8. Aktive tatimore të shtyra

Lëvizja në tatimin e shtyrë është si më poshtë:

	2019	2018
Më 1 janar	25,305,255	26,545,107
Shpenzimi nga tatimi i shtyrë	(4,780,400)	(1,239,852)
Aktive tatimore të shtyra	20,524,855	25,305,255

Aktivet tatimore të shtyra janë llogaritur me normën e tatim-fitimit prej 15% (2018:15%). Aktivet tatimore të shtyra u njohën për diferencat mes metodave të ndryshme të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale (AAM) dhe aktiveve afatgjata jomateriale (AAJM) për qëllimet kontabël dhe fiskale; kostove të çmontimit (të cilat njihen si aktive dhe provizion vetëm për arsye kontabël); zhvlerësimet e inventarit; e drejta e përdorimit të aktiveve dhe detyrimeve të qirasë (SNRF 16); dhe detyrime të përlogaritura si më poshtë:

Aktive tatimore të	AAM	AAJM	Inventar	SNRF	Provizion	Të tjera	Totali
Më 1 Janar 2018	23,383,875	-	1,977,150	-	86,877	1,097,204	26,545,106
Lëvizje	(1,777,004)	-	(20,280)	-	(12,808)	570,238	(1,239,852)
Më 31 Dhjetor 2018	21,606,871	-	1,956,870	-	74,071	1,667,442	25,305,255
Lëvizje	(5,002,581)	659	393,389	50,884	6,148	(228,898)	(4,780,400)
Më 31 Dhjetor 2019	16,604,290	659	2,350,259	50,884	80,219	1,438,544	20,524,855

9. Inventari

	2019	2018
Produkte të gatshme	25,542,669	59,327,503
Lëndët e para dhe të konsumit	43,288,926	31,655,716
Provizioni për zhvlerësim	(15,668,393)	(13,045,801)
Më 31 dhjetor	53,163,202	77,937,418

Lëvizjet në provizione për zhvlerësim paraqiten si më poshtë:

	2019	2018
Më 1 Janar	13,045,801	13,181,000
Lëvizje	2,622,592	(135,199)
Më 31 Dhjetor	15,668,393	13,045,801

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka nxjerrë jashtë përdorimit vlerën e inventarit prej 874,098 Lekë (2018: 940,719 Lekë).

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

10. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	2019	2018
Të arkëtueshme nga SICPA SA	5,486,497	3,622,400
Llogari tregtare të arkëtueshme	1,433,470	97,244
Të arkëtueshme të tjera	72,986	-
Më 31 dhjetor	6,992,953	3,719,644

Shoqëria zbaton SNRF 9 për të matur humbjet e pritshme të kredisë që përdor një shume të humbjes së pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së aktivit, për të gjitha të arkëtueshmet tregtare.

Shkalla e pritshme e humbjeve bazohet në profilet e pagesave të shitjeve për një periudhë prej tre vjetësh përpara datës 1 janar 2019 dhe humbjet historike përkatëse të kredisë të ndodhura brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme. Shoqëria ka identifikuar PBB-në dhe shkallën e papunësisë të vendeve në të cilat shet mallrat dhe shërbimet e saj si faktorët më të rëndësishëm dhe në përputhje me këtë rregullon normat e humbjeve historike bazuar në ndryshimet e pritura në këta faktorë (referojuni shënimit 4 për përcaktimin e normave).

Vlera e humbjes së kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera përcaktohet sipas matricës së parashikuar në tabelën e mëposhtme. Matrica e provizionimit bazohet në numrin e ditëve që një aktivi i ka kaluar afati i shlyerjes dhe normat e humbjeve llogariten siç përshkruhet në shënimin 4.

	Shkalla e humbjes	Vlera e mbartur bruto	HPK gjatë gjithë jetës së kredisë
Të arkëtueshme tregtare			
- Aktuale	0%	1,373,257	-
- 30 - 60 ditë	0%	5,486,497	-
- 60 – 90 ditë	0%	-	-
- > 90 ditë	0%	133,199	-
Totali i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera (shuma e mbartur bruto)		6,992,953	-

11. Parapagime dhe aktive të tjera

	2019	2018
Parapagime për shërbime	3,836,560	4,622,513
Shpenzime të shtyra	3,932,603	-
Garanci bankare	0	1,893,642
Parapagime ndaj personelit	1,378,690	749,761
Më 31 dhjetor	9,147,853	7,265,916

12. Mjete monetare dhe ekuivalentë

	2019	2018
Mjete monetare në arkë:		
Në Lekë	243,955	123,367
Në Euro	84,021	91,331
	327,976	214,698
Llogari rrjedhëse në bankë:		
Në Lekë	58,600	245,264
Në Euro	22,393,462	17,052,198
	22,452,062	17,297,462
Më 31 dhjetor	22,780,038	17,512,160

13. Detyrimi i qirasë

	2019	2018
Detyrimi i qirasë afatshkurtër	17,954,454	-
Detyrimi i qirasë afatgjatë	12,849,072	-
Më 31 Dhjetor	30,803,526	-

14. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

	2019	2018
SICPA SA	9,885,648	65,245,035
SICPA Holding SA	3,352,349	8,716,617
Furnitorë të tjerë	6,798,962	5,399,734
Më 31 dhjetor	20,036,959	79,361,386

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera ndaj SICPA SA më 31 Dhjetor 2018 përfshijnë 19,747,200 Lek të pagueshme ndaj SICPA SA në lidhje me uljen e kapitalit të paguar të Shoqërisë gjatë 2018.

15. Tarifa e koncesionit e pagueshme

	2019	2018
Me 1 janar	17,189,091	19,504,728
Pagesa gjatë vitit	(17,189,091)	(19,513,030)
Tarifa e koncesionit e llogaritur për vitin	18,603,374	17,197,393
Më 31 dhjetor	18,603,374	17,189,091

Prodhimi dhe shitja e pullave fiskale ka filluar prej vitit 2012, edhe pse Data Efektive siç përcaktohet nga Marrëveshja e Koncesionit (shënimi 1) nuk ishte arritur akoma. Duke ju referuar Marrëveshjes së Koncesionit, Shoqëria detyrohet t'i paguajë Autoritetit një tarifë koncesioni prej 2% të totalit vjetor të të ardhurave neto nga shitja e pullave fiskale. Tarifa e përlogaritur e koncesionit prej 17,189,091 Lekë për vitin 2018 u pagua gjatë vitit 2019. Tarifa e përlogaritur e koncesionit për vitin 2019 është në vlerën 18,603,374 Lekë dhe pritet të paguhet përgjatë vitit 2020.

16. Detyrime të tjera

	2019	2018
Detyrime të përlogaritura	10,191,212	10,450,862
TVSH e pagueshme	11,601,779	9,967,791
Detyrime tatimore lidhur me pagën	2,363,096	2,288,307
Të ardhura të shtyra	198,185	275,393
Tatimi në burim i pagueshëm	572,047	182,101
Më 31 dhjetor	24,926,319	23,164,454

Detyrimet e përlogaritura prej 10,191,212 Lekë (2018: Lekë 10,450,862) përbëhen kryesisht nga shpërblimet e përlogaritura për punonjësit dhe për shërbimet utilitare dhe profesionale.

Të ardhurat e shtyra prej 198,185 Lekë (2018: Lekë 275,393) përbëhen nga shitjet e faturuara për klientët, por që nuk janë njohur si të ardhura pasi dërgesa nga vendi i prodhimit drejt klientit ka ndodhur pas 31 dhjetor 2019.

17. Kapitali i paguar

Më 31 Dhjetor 2019 kapitali i paguar i Shoqërisë ishte 150,000,000 Lekë (2018: Lekë 300,000,000), i zotëruar 100% nga SICPA SA (shënimi 1), dhe i përbërë nga një kuotë me vlerë nominale 150,000,000 Lekë (2018: Lekë 300,000,000). Gjatë vitit 2019, bazuar në Vendimin e Ortakut të Vetëm të datës 24 shtator 2019, kapitali i paguar i Shoqërisë u ul me 150,000,000 Lekë. Gjithashtu Shoqëria, me Vendimin e Ortakut të Vetëm të datës 27 qershor 2019 ka shpërndarë dividendë nga fitimi i vitit 2018, në vlerën 24,446,000 Lekë.

18. Të ardhura nga kontratat me klientët

Të ardhurat e Shoqërisë më 31 Dhjetor paraqiten si më poshtë:

	2019	2018
Të ardhura nga kontrata me klientët	930,168,717	859,869,666
	930,168,717	859,869,666

Shoqëria nxjerr të ardhura nga transferimi i pullave fiskale në një moment kohor në rajonin gjeografik shqiptar.

19. Të ardhura të tjera

	2019	2018
Të ardhura të tjera	12,064,691	7,464,472
Fitimi neto nga shitja e aktiveve	-	549,252
Më 31 Dhjetor	12,064,091	8,013,724

Gjatë vitit 2019, Shoqëria ka faturuar SICPA SA shumë prej 12,064,691 Lekë (2018: Lekë 7,464,472) për shpenzimet e udhëtimit të kryera nga stafi gjatë udhëtimit të biznesit.

Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka realizuar një fitim prej 549,252 lekë nga shitja e një pjese të makinerive dhe pajisjeve (gjeneratorit).

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

20. Kosto e mallrave të shitur

Kosto e mallrave të shitur për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019 është 414,591,008 Lekë (2018: Lekë 376,278,963) përfshin koston e pullave fiskale të shitura.

Kosto e transportit të mallrave të shitura i ngarkohet klientëve sipas parashikimeve të Kontratës së Koncesionit dhe përfshihet në koston e mallrave të shitura, në vlerën neto. Kosto e mallrave të shitura përbëhet si më poshtë:

	2019	2018
Materiale	407,078,578	373,439,433
Shpenzime transporti	4,015,740	3,566,456
Fshirja e inventarit (shih shënimin 9)	874,098	940,719
Zhvlerësimi i inventarit (shih shënimin 9)	2,622,592	(135,199)
Kthimet e inventarit	-	(1,532,446)
Kosto e mallrave të shitur	414,591,008	376,278,963

21. Furnizime dhe shërbime

	2019	2018
Shërbime mbështetëse nga SICPA	36,911,250	37,968,750
Shpenzime qiraje	-	15,045,919
Shpenzime të ndryshme	10,214,198	11,479,898
Shërbime konsulence	2,726,740	2,065,800
Shpenzime qiraje për automjete	-	5,797,564
Shpenzime udhëtimi	13,176,068	14,845,853
Shërbime mirëmbajtje	3,050,014	3,115,403
Taksat doganore dhe taksat lokale	162,281	152,441
Shërbime profesionale	1,167,201	1,760,918
Shërbime utilitare	3,093,148	3,095,178
Shpenzime sigurimi	2,613,337	2,721,300
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,237,943	2,585,014
Shpenzime kompjuterike	1,078,253	1,678,856
Shërbime përfaqësimi	2,101,378	1,372,401
Shpenzime për shkatërrimin e mallrave	133,878	208,836
Shërbime rekrutimi	390,000	162,000
Humbje nga NBV e asetëve	152,838	-
Më 31 Dhjetor	79,208,526	104,056,131

Shpenzimet e konsulencës për vitin 2019 përbëhen nga shpenzime për konsulencë fiskale në vlerën 1,894,555 Lekë (2018: 1,524,283 Lekë), konsulencë ligjore në vlerën 589,185 Lekë (2018: 541,517 Lekë). Shërbimet e auditimit përfshihen tek shërbimet profesionale. Vlera në Lekë për vitin 2019 është 811,457 Lekë (2018: 1,501,815 Lekë).

Shpenzime të ndryshme përbëhen si më poshtë:

	2019	2018
Shpenzimet e rialokimit të punonjësve	-	1,267,449
Shpenzimet dhurata për punonjësit	939,781	1,157,425
Shpenzimet për punonjësit	646,890	603,528
Plani i Vazhdimt të Biznesit - Qiraja e ambienteve	-	117,450
Shpenzimet kancelarie	282,644	361,633
Gazeta, revista	-	390,060
Kostoja e lëvizjes së pajisjeve	8,333	62,654
Gjoha dhe penalitete	-	10,000
Shpenzimet e sigurimit	7,658,739	6,852,188
Shpenzime të tjera të ndryshme	677,811	657,511
Më 31 Dhjetor	10,214,198	11,479,898

22. Shpenzime për personelin

	2019	2018
Pagat	94,802,387	114,031,815
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,982,869	8,731,246
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore vullnetare	1,740,349	1,311,372
	105,525,605	124,074,433

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit 2019 ka qenë 40. Kostot e pagës së punonjësve (pagë bruto, bonus dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore) për vitin 2019, të ndara sipas kategorive detajohen si më poshtë:

Departamenti	Kosto e pagës	Bonus	Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore
Administrata	16,222,889	3,600,129	1,280,261
Magazina	7,050,656	528,844	915,192
Prodhimi	9,290,069	1,565,218	940,560
Kontrolli i Cilësisë	7,407,070	1,178,058	755,758
Suporti për klientët	7,203,321	1,577,311	512,911
Informatika	24,203,473	1,112,776	2,269,136
Mirëmbajtja e makinerive (Inxhinierët)	17,686,416	1,322,110	2,309,050
Total	89,063,894	10,884,446	8,982,869

23. Honorare për të drejtat e autorit

Honorare për të drejtat e autorit prej 49,008,984 Lekë (2018: Lekë 45,117,237) u përlogaritën bazuar në 5% të të ardhurave neto dhe janë të pagueshme ndaj SICPA Holding për të drejtat e përdorimit të emrit tregtar, të procesit të planifikimit dhe të prodhimit, si dhe për informacione që kanë lidhje me përvojën industriale dhe tregtare.

24. Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto

	2019	2018
Të ardhura financiare:		
Të ardhura nga kursi i këmbimit të përealizuara	241,418	-
Të ardhura nga kursi i këmbimit të realizuara	6,048,962	-
Fitime neto nga kursi i këmbimit	-	3,863,037
Efekti i ndryshimit në kohën e rimarrjes së provizionit	-	85,374
	6,290,380	3,948,411
Shpenzime financiare:		
Shpenzime nga kursi i këmbimit të përealizuara	(2,182,523)	-
Shpenzime nga kursi i këmbimit të realizuara	(3,048,456)	-
Efekti i ndryshimit në kohën e rimarrjes së provizionit	(40,986)	-
Komisione bankare dhe komisione për garanci	(509,311)	(514,859)
Shpenzime interesi nga detyrimi i qirasë	(2,028,363)	-
	(7,809,639)	(514,859)
Të ardhura/(shpenzime) financiare neto	(1,519,259)	3,433,552

25. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimin i tatim-fitimit është si më poshtë:

	2019	2018
Tatim fitimi aktual		
Shpenzimi për tatim-fitimin e vitit	(27,845,062)	(22,389,355)
Tatim fitimi i shtyrë		
Shpenzimi nga tatimi i shtyrë (shënimi 8)	(4,780,400)	(1,239,852)
Totali	(32,625,462)	(23,629,207)

Tatimi mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%). Më poshtë është një rikoncilim i tatimit mbi fitimin e llogaritur me normën e aplikueshme tatimore me shpenzimet e tatimit mbi fitimin:

	Norma efektive e tatimit	2019	Norma efektive e tatimit	2018
Fitimi para tatimit për vitin		206,745,863		151,992,123
Tatimi mbi fitimin me normën në fuqi	15.00%	31,011,880	15.00%	22,798,819
Shpenzime të panjohura	0.74%	1,525,097	0.44%	664,004
Rregullime të tjera të fitimit kontabël	-2.27%	(4,691,915)	-0.7%	(1,073,468)
Efekti i diferencave të përkohshme	2.31%	4,780,400	0.82%	1,239,852
Tatim mbi fitimin	15.78%	32,265,462	15.56%	23,629,207

Tatimi i pagueshëm mbi fitimin më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është i përbërë si më poshtë:

	2019	2018
Më 1 janar	(5,533,636)	(6,006,052)
Shpenzimi i tatim-fitimit për vitin aktual	(27,845,062)	(22,389,355)
Tatim-fitimi i paguar gjatë vitit	30,894,460	22,861,771
Më 31 dhjetor	(2,484,238)	(5,533,636)

Tatim-fitimi i paguar gjatë vitit 2017, përfshin një shumë prej 141,250 Lekë, e cila aktualisht është në pritje të konfirmimit nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj në mënyrë që Shoqëria ta përdorë atë në periudhat e ardhshme.

Trajtimet e pasigurta tatimore

Detyrimet aktuale të tatimit mbi të ardhurat nuk përfshijnë shuma në lidhje me pasiguritë në lidhje me zbritjet tatimore të marra për çdo shpenzim. Drejtimi vlerëson se nuk do të ketë ndonjë ekspozim të mundshëm për të kërkuar shlyerje nëse kontestohet nga autoritetet tatimore. Detyrimet e tatimit mbi të ardhurat do të vlerësohen plotësisht kur të kryhen kontrollet tatimore në lidhje me deklaratimet përkatëse tatimore.

26. Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime dhe procese gjyqësore të ndryshme. Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se kosto përfundimtare e zgjidhjes së këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimet në aktivet neto, përveç atyre për të cilat janë njohur provizione në këto pasqyra financiare.

Në maj të vitit 2015, Shoqëria iu nënshtrua një kontrolli tatimor nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve e Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila i vendosi Shoqërisë detyrime shtesë tatimore në shumën 1,388,735 Lekë, gjobë në shumën 304,133 Lekë si dhe reduktoi humbjen fiskale për 2012 për shumën prej 50,512,779 Lekë. Vendimi u apelua nga Shoqëria përmes kërkesës së kundërshtimit drejtuar Drejtorisë së Apelit të Tatimeve, e cila gjykoj në favor të Shoqërisë për pjesën më të madhe të detyrimeve dhe reduktimit të humbjeve fiskale dhe ka lënë në fuqi reduktimin e humbjes fiskale për vitin 2012 për shumën prej 6,805,138 Lekë. Vendimi i Drejtorisë së Apelit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve e Tatimpaguesve të Mëdhenj u ankimua nga Shoqëria në Gjykatën Administrative, e cila pranoi kërkesën e Shoqërisë. Më 13 Dhjetor 2018 Gjykata Administrative ka vendosur shfuqizimin e vendimit, për uljen e humbjes fiskale për vitin 2012 për shumën prej 6,805,138 Lekë. Pas rekursit të të paditurve, çështja do të shqyrtohet nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, për të cilën Shoqëria mbetet ende në pritje.

Nga ana tjetër, për të njëjtën çështje, Shoqëria është e përfshirë si një palë e tretë në procesin e gjykimit mes institucioneve brenda administrates tatimore. Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor u kundërshtua nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tatimpaguesve të Mëdhenj në Gjykatën Administrative të Tiranës, e cila gjithashtu gjykoj në favor të Shoqërisë. Vendimi i Gjykatës Administrative të Tiranës u ankimua nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe aktualisht është në pritje të gjykimit nga Gjykata e Apelit.

Detyrime të mundshme tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të 2017, është objekt i interpretimeve të ndryshme përsa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Angazhime kapitale

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara në datën e raportimit.

27. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të jenë palë të lidhura nëse një palë ka mundësinë të kontrollojë ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Në palët e lidhura me shoqërinë përfshihen SICPA SA, si pronar i vetëm i shoqërisë, SICPA Holding SA, të cilët janë pjesë e grupit SICPA si dhe Drejtimi i SICPA. Shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe gjendjet në fund të periudhave 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Të drejta ndaj palëve të lidhura

	2019	2018
SICPA SA (shënimi 10)	5,486,497	3,622,400
	5,486,497	3,622,400
Detyrimet ndaj palëve të lidhura	2019	2018
SICPA Holding SA (shënimi 14)	3,352,349	8,716,617
SICPA SA (shënimi 14)	9,885,648	65,245,035
Totali	13,237,997	73,961,652

Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Blerjet gjatë vitit	2019	2018
Blerja e lëndës së parë	197,488,798	185,635,965
Blerja e mallrave të gatshme	162,941,684	175,650,564
Blerje pjesë këmbimi	21,293,229	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	6,765,401	111,718,301
Shpenzimet e rialokimit të punonjësve	-	22,888,633
Honorare për të drejtat e autorit (shënimi 23)	49,008,984	45,117,237
Shërbime mbështetëse (shënimi 21)	36,911,250	37,968,750
Tarifa për licencën e Microsoft (shënimi 21)	1,078,253	1,678,856
Totali	475,487,599	580,658,306

Shitjet gjatë vitit

	2019	2018
Të ardhura nga rialokimi i punonjësve (shënimi 19)	12,064,691	7,464,472
Totali	12,064,691	7,464,472

Kompensimi i personelit drejtues kryesor

Shpenzime	2019	2018
Pagat, kompensimet dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore	6,579,372	34,097,370
<i>Xavier Davard</i>	-	27,900,672
<i>Samir Shqarri</i>	6,579,372	6,196,698
Pagesa të bonuseve	1,604,074	882,307
<i>Samir Shqarri</i>	1,604,074	882,307
Sigurimi i sëmundjeve, jetës dhe familjes	117,816	33,371
<i>Samir Shqarri</i>	117,816	33,371
Shpenzimet e rialokimit të punonjësve	-	1,267,449
<i>Xavier Davard</i>	-	1,267,449
Bonus dhe pushime të përlllogaritura	1,329,636	474,382
<i>Samir Shqarri</i>	1,329,636	474,382
Total	9,630,898	36,754,879

28. Ngjarje pas datës së raportimit

Egzistenca e Koronavirusit të ri (Covid-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe tashmë ka shpërthyer dhe është përhapur edhe përtej kufijve të Kinës duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi. Shoqëria e konsideron këtë pandemi si një ngjarje post raportimi për të cilën nuk ka nevojë të bëhen rregullime në pasqyrat financiare të vitit 2019. Duke qenë se kjo ngjarje është akoma në zhvillim e sipër, Shoqëria në këtë moment, nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një vlerësim sasior të impaktit që do të ketë kjo pandemi tek financat e Shoqërisë.

Nuk ka pasur ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare.